

Akademik Vasil S. Tole

*“Cili je ti more burrë?”*

kushtuar Arap Çeloleskajt

*“Cili je ti more burrë”* është vallja e kënduar e iso-polifonisë labe që shoqëroi si kolonë zanore e pashpallur zyrtarisht, gjithë vitin e 100 vjetorit të Pavarësisë. Ky krijim i trashëgimisë sonë kulturore u shndërrua në një kryevepër shpirtërore e njohur edhe ndërkombëtarisht nga UNESCO, falë interpretimit mjeshtëror të grupit të valleve të Vranishtit me korife Arap Çeloleskajn.

*Amin Arap për vallen tënde!*

Sot në këtë ditë të mbrame për Ty, familjen, miqtë dhe shokët e tu të shumtë në mbarë Shqipërinë, në ditën kur populli thotë *“Dy vdekje s’ka dhe nga një nuk shpëton dot”*, të përcjellim Ty në jetën tjetër, se thjesht ke ndërruar jetë Arap, asgjë më shumë. Gjatë gjithë jetës tënde këndove kundër vdekjes për të lartësuar jetën, trimat dhe mbi të gjitha Shqipërinë. Si na pergjigjeshe kur të pyesnim se përse këndon? - *“Gazi dhe kënga, mortjes thyerë këmba”*, thoje me të qeshur!

*Amin Arap për harenë dhe këngën tënde!*

Në intervistën e fundit që të pamë, në nëntor 2012 (*se zë s’kishe më për të kënduar*), në muajin që e doje aq shumë, zëri të ishte fikur, por syri jo. Duke pëshpëritur i le amanetet e tua. The të vërtetat e mëdha. The, që vallen dhe këngën popullore i ke të trashëguara, të gjetur nga brezat më të parë, të

mësuar nga pleqtë e moshuar; the që ashtu si iso-polifonia punën e kreve bashkë me shokët e tu, me mjeshtrat Muhamet Tartari, Spiro Cino, Ethem Shkurtaj, Mithat Habilaj, Jazo Hibraj, me vëllain tënd bilbilin Lesko Celoleskaj, Myrdar Kongjonin, Bektash Pashajn, por edhe me më të rinjtë e Vranishtit: Aulon Tartarin, Ledion Shkurtajn, Leando Lapajn etj. The që doje të ktheheshe prapë në skenë. Aty për aty na the edhe vargjet e tua të fundit!

*Shqipëri gjoks suferina*

*Zemër zjarrta si stërralli*

*Djepi yt që tundi trima*

*Burra si Smail Qemali!*

*Amin Arap për fjalën tënde!*

Sot qe s'të kemi më mes nesh, kuptojmë se ishe më shumë se një simbol. Ti Arap përfaqësoje trininë e shenjtë të krijimit muzikor popullor. Tek ty ishin bashkuar *muzika, vallëzimi dhe fjala*. Ti ishe një homerist i kohëve moderne sepse të treja artet i kishe mishëruar organikisht në qenien tënde, në një të vetme ndjenjë artistike. Ti i përkisje sojit të artistëve që filluan ta lartësonin emrin e tyre si Orfeu dhe Demodoku, për të cilët shkruan Homeri. Eh sikur të ndodhte që Homeri të të njohte ty! Ndër mend më kalojnë interpretimet e tua dhe natyrshmëria kur këndoje, kur interpretoje në longar e cylë dyjare, kur kërreje vargje, pale pastaj kur kërceje.

*Amin Arap për artin tënd!*

Të kisha mik Arap dhe ti e dije këtë. Se më çmoje si mik, bëre të pamundurën bashkë me shokët e grupit të Vranishtit, në vitin 2002, kur të kërkova edhe Ty edhe Muhametit, që të bënim një regjistrim dinjitoz të valles së kënduar “*Cili je ti more burrë*”. Eshtë vallja e kënduar që të gjithë e dëgjojnë dhe e çmojnë sot, falë Arapit dhe grupit të Vranishtit dhe mjeshhtërisë së regjistrimit të kryer nga kompozitori Edi Balili, ish-studenti im i kompozicionit, aty në sallën e pallatit të kulturës “*Petro Marko*”, në Vlorë. Ishte po nëntor. Askush nuk e diti se sa i vështirë ishte ai regjistrim për Ty, pasi vallja vetëm duhej kënduar pa u kërcyer, për shkak të zhurmës dhe përplasjeve që lëshonin këmbët e valltarëve gjatë interpretimit. Do ta kërcej me mendje më the dhe mbylle sytë gjatë gjithë regjistrimit. Eh Arap. I vure krahë valles dhe shkove e fluturove në gjithë viset shqiptare, u fute thellë në historinë e saj, kush e di mbase takove edhe Ismail Qemalin me shokët e tij për t’ja bërë vetë Atij pyetjen “*Cili je ti more burrë*”? Kur u ktheve dhe hape sytë, pe që kënga kishte mbaruar dhe bashkë me të solle edhe përgjigjen e pyetjes: Mbrapa të vjen historia! Po, po! Mbrapa të vjen lavdia Arap Çeloleskaj!

*Amin Arap!*

Tiranë, 4 Janar 2013